

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6447
E shtunë, 23 tetor 2021
çmimi 0.40 €

Fushata zgjedhore për balotazh, vetëm pesë ditë

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI) KA ORGANIZUAR KONFERENCËN "NDIKIMI I DIALOGUT ME SERBINË NË POLITIKËN E JASHTME TË KOSOVËS?"

VAZHDIMI I STATUS QUOS SË DIALOGUT DËMTON KOSOVËN



FAQE 4-5

Përfaqësuesit e partive politike dhe mbikëqyrësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë folur të premten për rëndësinë e përfundimit të këtij procesi për të ardhmen e Kosovës. Në një konferencë të organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ata kanë deklaruar se vazhdimi i status quos i këtij procesi po e dëmton Kosovën. Sipas tyre, vazhdimi i kësaj gjendje i shkon përshtati vetëm Serbisë

FSK-SË IU SHTUAN EDHE 180 USHTARË TË RINJ

FAQE 7



QEVERIA NUK IA MBYLL DERËN UNMIK-ut

FAQE 3

AKTUALE



NIKOLLA: KËSHILLI I EVROPËS DO TË JETË I PAPLOTË DERISA TA PRANOJË KOSOVËN F. 7

NË UP NUK PËRFILLEN MASAT KUNDËR PANDEMISË F. 5

MË 29 NËNTOR FILLON INTERVISTIMI I 21 KANDIDATËVE PËR DREJTOR TË AKK-së F. 6

NIS VAKSINIMI I QYTETARËVE ME EKIPE MOBILE NË PRISHTINË F. 7

EKONOMI



EKSPORTI DHE IMPORTI GJATË SHTATORIT, ASK-ja PUBLIKON TË DHËNAT F. 8

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA PËR TREGJET E ENERGJISË ELEKTRIKE SHQIPËRI - KOSOVË F. 8

SPORT



DARDANET U19 FITOJNË EDHE NË NDESHJEN E DYTË NË KUALIFIKIMET PËR EURO 2022 F.10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht--Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Lindja e Mesme, në fokus të bisedimeve Izrael - Rusi

JERUSALEM, 22 TETOR - Kryeministri i Izraelit, Naftali Bennett, po viziton për herë të parë Rusinë që nga zgjedhja e tij në këtë pozitë në muajin qershor të këtij viti. Bisedimet me presidentin rus Vladimir Putin pritet të fokusohen në Lindjen e Mesme. Televizioni shtetëror rus transmetoi pamjet e fillimit të bisedimeve në qytetin turistik të Soçit në brigjet e Detit të Zi. Putini ka thënë se të dyja vendet kanë lidhje "unike" dhe që shpresonte në vazhdimin e raporteve të mirëbesimit që kishte me qeverinë e mëparshme izraelite të udhëhequr nga Benjamin

Netanyahu. Ndërsa kryeministri Bennett i tha Putinit se Izraeli e sheh atë si "një mik të vërtetë të popullit hebre" dhe vlerësoi lart përpjekjet e luftës sovjetike kundër Gjermanisë naziste. Gjatë nisjes për në Soçi, Bennett tha se sa i takon politikës së jashtme të vendit të tij, marrëdhëniet me Moskën janë një "element i rëndësishëm". Kryeministri izraelit konfirmoi se të dy udhëheqësit do të diskutojnë për "situatën në Siri dhe angazhimet për ta parandaluar programin bërthamor ushtarak të Iranit". Moskë është një nga nënshkruesit

e një marrëveshjeje të vitit 2015 mes Iranit dhe fuqive botërore. ShBA-ja është tërhequr nga marrëveshja më 2018 dhe ka vendosur sanksione të ashpra nga Iranit. Teherani ka kohë që po i shkel kushtet e marrëveshjes. Të dyja vendet po bëjnë përpjekje ta ringjallin marrëveshjen përmes bisedimeve indirekte në Vjenë të Austrisë, por nuk është shënuar ndonjë përparim. Muajin e kaluar Bennett i tha Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara se Izraeli "nuk do të lejojë që Irani të posedojë armë bërthamore".



Rritje e numrit të rasteve me Covid në Evropë



BRUKSEL, 22 TETOR - Letonia u fut në izolim njëmuor, pasi numri i rasteve të reja me koronavirus shënoi rekord. Autoriteti shëndetësor i Letonisë raportoi gati 3 000 raste të reja pozitive më 21 tetor. Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve tha se Letonia aktualisht ka shkallën më të lartë të infeksionit në Evropë në raport me popullsinë. "Do të kalojmë në një regjim më të rreptë për katër javë", ka deklaruar kryeministri letonez, Krisjanis Karins, duke bërë thirrje edhe për vaksinim më të madh. Vetëm pak më shumë se gjysma e popullsisë letoneze është plotësisht e vaksinuar kundër koronavirusit. Masat e reja të izolimit do ta përfshijnë orën policore gjatë natës. Në Bullgari autoritetet spitalore raportuan se numri i pacientëve të shtruar me koronavirus është rritur për 30

për qind gjatë muajit të fundit. Vetëm një në katër persona të rritur është plotësisht i vaksinuar në Bullgari. Në Rumani, ku shifra ditore e të infektuarve ka arritur në 19 000 këtë javë, një në tre të rritur është i vaksinuar. Në Ukrainë autoritetet shëndetësore thanë se kanë regjistruar mbi 22 000 raste të të infektuarve në 24 orët e fundit. Shifra thyen rekordin e mëparshëm në këtë vend prej 20 341 rastesh të regjistruar më 3 prill. Vendet në Evropën Lindore janë duke bërë përpjekje për t'i rritur normat e vaksinimit, të cilat janë më të ulëtat në Bashkimin Evropian. Ka frikë se shkalla e lartë e të infektuarve mund të prodhojë variante të reja të koronavirusit. Rusia ka raportuar të enjten raste të izoluar me një nënvariant të variantit "Delta" që besohet të jetë edhe më ngjitur.

Inteligjenca amerikane: Ndryshimet klimatike do të sjellin tensione

Nju-Jork, 22 tetor - Ndryshimet klimatike do të çojnë në rritjen e tensioneve ndërkombëtare, paralajmëron komuniteti i inteligjencës amerikane. Sipas raportit të publikuar, vendet do të zihen për mënyrat e reagimit, ndërsa efektet do të ndihen më së shumti në vendet e varfra, të cilat kanë më pak kapacitete për t'u përshtatur. Raporti vlerëson ndikimin e klimës në sigurinë kombëtare deri në vitin 2040. Ai thotë se vendet do të përpiqen t'i mbrojnë ekonomitë e tyre dhe të kërkojnë avantazhe në zhvillimin e teknologjive të reja.

Sipas raportit, bota do të dështojë të bashkëpunojë dhe kjo do të sjellë konkurrencë të rrezikshme dhe paqëndrueshmëri. Raporti prej 27 faqesh është i pari i tillë i publikuar nga të 18 agjencitë e inteligjencës në Shtetet e Bashkuara. Ai vjen vetëm disa ditë para se presidenti amerikan Joe Biden të ndjekë një samit për klimën në Gllasgo të Skocisë, ku pritet të bëhen përpjekje për aritjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare. Raporti identifikon 11 vende dhe dy rajone, ku energjia, ushqimi, uji dhe siguria shëndetësore janë në

rrezik të veçantë. "Ato janë më të varfra dhe më pak të afta për t'u përshtatur, gjë që e rrit rrezikun e paqëndrueshmërisë dhe të konfliktit të brendshëm", thuhet në raport. Pesë nga 11 vendet janë në Azinë Jugore dhe Lindore: Afganistani, Birmania, India, Pakistani dhe Koreja e Veriut; katër vende janë në Amerikën Qendrore dhe Karaibe: Guatemala, Haiti, Honduras dhe Nikaragua. Kolumbia dhe Iraku janë dy vendet e tjera. Afrika Qendrore dhe shtetet e vogla në Paqësor janë, gjithashtu, në rrezik, thekson raporti.



Qeveria nuk ia mbyll derën UNMIK-ut

PRISHTINË, 22 TETOR - Roli i misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK, u zbeh pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe vendosjes së misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX) në vitin 2008. Por, që nga ajo kohë UNMIK-u vazhdon të operojë në të gjithë territorin e Kosovës. Udhëheqësit e UNMIK-ut takuan e ritakuan kryeministra, si dhe politikanë të tjerë të rëndësishëm të Kosovës. Dikur kundërshtar i madh i UNMIK-ut, kryeministri Albin Kurti më 11 tetor 2021 e priti në zyrë shefin aktual të këtij misioni, Zahir Tanin.

Në komunikatën pas takimit, kryeministria tha se takimi Kurti - Tanin ndodhi në prag të mbledhjes së Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ku shefi i UNMIK-ut do ta paraqiste raportin e rregullt të zhvillimeve në Kosovë. Por, takime të tilla të një niveli kaq të lartë ndërmjet kryeministrit dhe shefit të UNMIK-ut nuk do të duhej të ndodhin në realitet, thotë për "Radion Evropa e Lirë" ish-ministria Edita Tahiri.

Tahiri konsideron se misioni i UNMIK-ut në Kosovë prej vitesh është një strukturë fosile së cilës nuk duhet dhënë mundësi që ta arsyetojë ekzistencën. "Nuk është mirë nga ana e qeverisë dhe kryeministrit të mbajë takime me UNMIK-un, sepse duke mbajtur takime të niveleve të larta jepet sinjali që (qeveria) ende e mbështetë ekzistimin e UNMIK-ut në Kosovë", vlerëson Tahiri.

Ish-ministria Tahiri thotë se këtë mision nuk duhet injoruar tërësisht por, sipas saj, komunikimi dhe bashkëpunimi duhet të vendoset vetëm në nivel teknik. "Kontakte mund të kihet sepse ata janë në Kosovë, por ato nivele duhet të jenë nivele teknike, nivele të zyrtarëve administrativë dhe jo takime të niveleve politike, pra siç është puna e kryeministrit dhe shefit të UNMIK-ut", thotë Tahiri.

Takimi ndërmjet kryeministrit Kurti dhe shefit të UNMIK-ut, Tanin, nxiti kritika në Kosovë, pasi u tha se kështu po fuqizohet roli i këtij misioni, i cili ligjërisht nuk ka asnjë kompetencë ekzekutive që nga viti 2008.

Në zyrën e kryeministrit të Kosovës thonë se janë të mendimit se misioni i UNMIK-ut është i panevojshëm që nga shpallja e pavarësisë. Por, sipas qeverisë, meqë ky mision është ende në Kosovë, do t'i presin sa herë që ata kërkojnë takim. "UNMIK-u është këtu sepse OKB-ja refuzon ta pezullojë mandatin e tij, ndonëse është një trup i OKB-së i cili që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës është i panevojshëm dhe nuk ka asnjë kompetencë ekzekutive. Derisa ata janë këtu ne i presim kur kërkojnë takim", thuhet në një përgjigje të shkruar të Qeverisë së



Kosovës.

Në qeveri thonë se kryeministri Kurti e ka bërë të qartë gjithmonë qëndrimin e tij karshi misionit të UNMIK-ut që, sipas ekzekutivit, është dashur qysh moti të shuhej. "Kryeministri e ka bërë gjithmonë të qartë qëndrimin e tij karshi UNMIK-ut qysh moti dhe si asnjë lider tjetër në Kosovën e pasluftës. Prania e veprimtaria e UNMIK-ut është e panevojshme. Pas shpalljes së pavarësisë dhe konfirmimit të ligjshmërisë së saj nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, trup ky i Kombeve të Bashkuara, mandati i misionit të UNMIK-ut tashmë është trefish i tejkaluar", thuhet në përgjigjen e zyrës së kryeministrit Kurti.

Pavarësisht prej mungesës së kompetencave ekzekutive, UNMIK-u raporton vazhdimisht për situatën në Kosovë në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Nga viti 1999, bazuar në Rezolutën 1244, UNMIK-u ka raportuar mbi situatën në

Kosovë në periudha të rregullta tremujore. Së fundmi, pas kërkesës së diplomatëve kosovarë në Shtetet e Bashkuara dhe mbështetjes së këtij shteti, si dhe të Mbretërisë së Bashkuar, raportimet tani bëhen dy herë në vit.

Mbledhja e fundit e Këshillit të Sigurimit të OKB-së u zhvillua më 15 tetor dhe aty shefi i UNMIK-ut, Zahir Tanin, u kritikua se akuzoi institucionet e Kosovës për shkaktimin e tensioneve në komunat në veri të Kosovës ku shumica që jeton atje janë serbë të Kosovës.

Tanin në fjalën e tij tha se Kosova e mori kokë më vete aksionin për vendosjen e masës së reciprocitetit, veprim ky që, sipas tij, shkaktoi krizë gati dyjavore në komunat në veri, të banuara me shumicë serbe. Më 30 shtator në Bruksel palët nga Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për targa, sipas së cilës, simbolet shtetërore në targa do të mbuloheshin me letra ngjitëse.

UNMIK-u: Do të jemi këtu derisa Këshilli i Sigurimit nuk merr vendim tjetër

"Radio Evropa e Lirë" ka pyetur misionin e UNMIK-ut nëse konsideron se ende është e nevojshme prania e tij në Kosovë. Në përgjigjen e këtij misioni thuhet se ata do të jenë këtu derisa Këshilli i Sigurimit i OKB-së nuk do të marrë një vendim tjetër. "Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit e Kombeve të Bashkuara përcakton mandatin e pranisë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë në Kosovë. Çdo rregullim i këtij mandati kërkon një vendim nga Këshilli i Sigurimit", thuhet në përgjigjen e UNMIK-ut.

UNMIK-u ka shpjeguar se aktualisht bashkëpunon në fusha të ndryshme me institucionet e Kosovës si dhe me shoqërinë civile. UNMIK-u thotë se, bazuar në mandatin që ka në pesë vjetët e fundit, mes të tjerash, ka ndarë rreth nëntë milionë euro për fuqizimin e rendit dhe ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve.

Në misionin e UNMIK-ut thonë se shefi i këtij misioni "zhvillon konsultime të vazhdueshme me liderhipin e Prishtinës dhe të Beogradit", duke shtuar se takime të tilla zhvillojnë edhe me misione të tjera ndërkombëtare në Kosovë, përfshirë këtu KFOR-in, OSBE-në dhe EULEX-in.

Miftaraj: UNMIK-ut t'i kërkohet raportim i drejtë

Drejtori i Institutit të Kosovës për Drejtësi, Ehat Miftaraj, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se çdo takim që zyrtarët e Kosovës mund

të kenë me përfaqësues të UNMIK-ut, duhet të kërkohet që të ketë raportim të drejtë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Miftaraj thotë se në këtë duhet të insistohet përderisa OKB-ja nuk e shfuqizon Rezolutën 1244. "Takime të tilla do të duhej të kontribuonin që Kosova të kërkojë nga UNMIK-u që në raportet që bëhen në Këshill të Sigurimit, të thuhet e vërteta e që, në rastin e fundit, fatkeqësisht kjo nuk ndodhi pasi që mund të themi pas një kohe jashtëzakonisht të gjatë, raportimi i zotit Zahir Tanin, i cili është raportimi i fundit i tij si përfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm, mund të themi që nuk e theksoi realitetin, por ishte i njëanshëm", thotë Miftaraj.

Miftaraj vlerëson se në raportimin e tij të fundit në seancën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, shefi i UNMIK-ut, Zahir Tanin, ka dalë jashtë kornizave dhe praktikave që, sipas tij, ky mision ka aplikuar në raportim që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Pavarësisht prej mënyrës se si raporton UNMIK-u për situatën në Kosovë, ish-ministria për Dialog, Edita Tahiri, mendon se Kosova duhet të angazhohet më shumë në aspektin diplomatik sa i takon kërkesës për shfuqizim të Rezolutës 1244.

Këtë gjë, sipas saj, Kosova do të mund ta bënte duke shfrytëzuar ndihmën e Shteteve të Bashkuara. "Atë që dua të them është se është fuqia dhe ndikimi diplomatik i ShBA-së, i cili mund të bëjë që të anulohet Rezoluta 1244 nga Këshilli i Sigurimit sepse ajo është baza legale e funksionimit të UNMIK-ut aktual. Natyrisht edhe Kosova mund të zhvillojë diplomaci në këtë drejtim", thotë Tahiri.

Çfarë ishte dhe çfarë ka mbetur nga UNMIK-u?

Misioni i Kombeve të Bashkuara, UNMIK, u vendos në Kosovë për herë të parë në qershor të vitit 1999. Ky mision kishte për qëllim që të shërbente si prani ndërkombëtare civile dhe ushtarake pas miratimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

OKB-ja e kishte sjellë këtë mision që të ndihmonte në rindërtimin e institucioneve të Kosovës, pasi gjatë luftës sistemi gjyqësor në Kosovë ishte "rrënuar" dhe kishte "nevojë urgjente për të ndërtuar sundim të vërtetë të ligjit, duke përfshirë edhe përmes rindërtimit të menjëhershëm të një gjyqësori të pavarur, të paanshëm dhe shumetnik". UNMIK-u pësoi një ristrukturim të thellë në vitin 2008 kur Kosova shpalli pavarësinë dhe në Kosovë arriti një mision tjetër ndërkombëtar, misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), të cilit iu bartën kompetencat që mbante UNMIK-u.

Aktualisht, UNMIK-u ka prani shumë të kufizuar në Kosovë. Në mbledhjen e fundit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ShBA-ja përsëriti kërkesën për mbyllje të këtij misioni.



INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI) KA ORGANIZUAR KONFERENCËN “NDIKIMI I DIALOGUT ME SERBINË NË POLITIKËN E JASHTME TË KOSOVËS?”

Vazhdimi i status quos së dialogut dëmton Kosovën

Përfaqësuesit e partive politike dhe mbikëqyrësit e procesit të dialogut Kosovë - Serbi kanë folur të premtën për rëndësinë e përfundimit të këtij procesi për të ardhmen e Kosovës. Në një konferencë të organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ata kanë deklaruar se vazhdimi i status quos së këtij procesi po e dëmton Kosovën. Sipas tyre, vazhdimi i kësaj gjendje i shkon përshtati vetëm Serbisë

EPOKA ERE

Muhamet KOÇI

PRISHTINË, 22 TETOR - Përfaqësuesit e partive politike dhe monitoruesit e dialogut Kosovë - Serbi janë shprehur kundër vazhimit të status quos të këtij procesi. Në konferencën “Ndikimi i dialogut me Serbinë në politikën e jashtme të Kosovës?”, të organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ata kanë thënë se vazhdimi i status quos dëmton më së shumti Kosovën. Në këtë konferencë është publikuar edhe hulumtimi lidhur me ndikimin e procesit të

dialogut në planin e jashtëm të Kosovës.

Eugen Cakolli, hulumtues dhe autor i këtij punimi, ka vlerësuar se aktualisht procesi i dialogut ndodhet në status quo, e cila më së shumti i shkon përshtati Serbisë. “Është e paqartë periodha kohore kur eventualisht mund të arrihet një marrëveshje përfundimtare mes palëve. Situata e tanishme nuk duhet aspak shpresëdhënëse, sidomos për Kosovën. Në njërin anë kemi në Serbi zëra gjithmonë të shtuar dhe qëndrim se asnjëherë nuk do të ketë njohje të Kosovës, ndërsa në anën tjetër në Kosovë kemi

anashkalim të paktën deklarativ të kësaj teme dhe polarizim të skajshëm që ka vënë procesin e dialogut në status quo. Një status quo e tillë do të humbin të dyja palët, ndonëse është më e qartë se humbja më e madh do të ishte Kosova”, ka deklaruar ai. Sa iu përket rreziqeve që një status quo e tillë ka në raport me shtetin e Kosovës, Cakolli ka përmendur rrezikun e shndërrimit të raporteve të Kosovës me aleatët e saj ndërkombëtarë në “marrëdhënie të presionit”, kufizimin e burimeve dhe përkrahjes financiare dhe pamundësinë e njohjeve të reja

apo anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Ai ka kërkuar nga qeveria që në bashkërendim me presidentin dhe Kuvendin e Kosovës të bëjë një balancë të mirëarsyetuar mes nevojës për përmbylljen e shpejtë të dialogut dhe prolongimit të tij, në funksion të konsolidimit të jashtëm dhe zhvillimit të brendshëm të Kosovës.

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacolli-Dalipi, ka thënë se marrëveshja finale me Serbinë duhet të jetë për njohje reciproke në kufijtë aktualë dhe duke ruajtur kushtetutshmërinë e vendit. “Përveç dialogut çfarë ka ndikuar në politikën tonë të jashtme, duhet përmendur se ne nuk kemi pasur ambasada të përgatitura që të shtojnë tutje agjendën e Kosovës. Ambasadat tona janë udhëheq prej njerëzve që kanë qenë fytyra politike të partive në pushtet që shumicën

e rasteve u kanë shërbyer partive politike dhe interesave të tyre private”, ka thënë Pacolli-Dalipi.

Nënkryetarja e LDK-së, Shqipe Mjekiqi, ka deklaruar se mungesa e një marrëveshje finale po e pengon anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. “Një marrëveshje gjithëpërfshirëse përfundimtare duhet të sjellë njohje reciproke të dy vendeve, gjithashtu duke respektuar kufijtë aktualë dhe kushtetutshmërinë e Kosovës”, ka thënë ajo, duke shtuar se status quoja dëmton Kosovën. “Staus quoja nuk është e mirë për dyja palët, por aq më tepër për Kosovën për shkak se ne jemi në një situatë tjetër, pasi nuk kemi liberalizim të vizave. Pastaj ju keni përmendur në raport se mungesa e një marrëveshje finale pengon në anëtarësimin e Kosovës në

organizata ndërkombëtare, s'po flasim vetëm për kohën sa kishte moratorium, por në vazhdimësi", është shprehur ajo. Ndërsa anëtari i kryesisë së PDK-së, Bernard Nikaj, ka vlerësuar se në kuadër të politikës së jashtme duhet të dallohet objektivi për rrugëtim me BE-në dhe anëtarësim në organizata të tjera ndërkombëtare. Ai ka kërkuar që Qeveria e Kosovës t'i definojë qartë objektivat e Kosovës në dialog. "Politika jonë e jashtme në raport me BE-në ka qenë dhe vazhdon të jetë ngushtë e lidhur me atë se çfarë është arritur, çfarë po bëhet dhe çfarë mund të arrihet në dialogun në mes të

Kosovës dhe Serbisë. Në anën tjetër, ne në vazhdimësi kemi provuar dhe duhet të vazhdojmë të provojmë që ta ndajmë objektiven në anëtarësim në BE dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare dhe fuqizim të subjektivitetit tonë ndërkombëtar me palë të treta", ka deklaruar Nikaj, duke shtuar se Kosova është në një moment ku sa më shpejt duhet të definojë dhe ndërtojë një konsensus politik dhe shoqëror për dialogun.

Sa i përket rolit të partive opozitare, Nikaj ka theksuar se ato duhet të jetë në përputhje me atë që ka definuar Gjykata

Kushtetuese dhe zhvillimet e mëparshme.

Pjesë e kësaj konference ishte edhe ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Tomas Kolly, i cili ka kërkuar nga institucionet e Kosovës të përqendrohen në anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Ai ka potencuar rëndësinë e politikës së jashtme brenda sistemit qeverisës të një vendi, posaçërisht në rastin e Kosovës ku politika e jashtme është shumë më e rëndësishme krahasuar me vendet e tjera.

Kolly ka vlerësuar se dialogu me Serbinë është pjesë shumë e rëndësishme e politikës së jashtme të Kosovës, duke shtuar se ky proces ndikon jetën e

pothuajse secilit qytetar. "Politikat e jashtme janë gjithmonë çështje e veçantë e sistemit të qeverisjes dhe sidomos në Kosovë ku politikat e jashtme janë tërësisht thelbësore, sidomos kur flitet për dialogun. Mendoj se politika e jashtme ka pasur ndikim në secilin ndikim në secilin qytetar dhe e njëjta është e rëndësishme më shumë për Kosovën sesa për shtetet e tjera", ka deklaruar ai.

Në anën tjetër, Demush Shasha, drejtor ekzekutiv i Institutit EPIK, ka thënë se marrëveshja me Serbinë është kyçe për avancimin e perspektivës evropiane të Kosovës, duke rikujtuar se kjo çështje është

kryesorja në çdo komunikim ndërkombëtar të liderëve të Kosovës me liderët e shteteve të tjera.

Në hapjen e konferencës, drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës, Ismet Kryeziu, ka folur për punën e KDI-së në raport me procesin e dialogut dhe mbështetjen e vazhdueshme të ofruar ndaj Kuvendit të Kosovës në mbikëqyrjen sa më efektive të këtij procesi. Ai ka theksuar nevojën e angazhimit të shoqërisë civile dhe bashkëpunimin sa më të madh të këtij sektori, si në Kosovë ashtu edhe në Serbi, përmes krijimit të platformave të përbashkëta.

Në UP nuk përfillen masat kundër pandemisë



PRISHTINË, 22 TETOR - Pa ndonjë pengesë, studentët në Fakultetin Juridik dhe Ekonomik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" hyjnë brenda objektit ku kanë nisur të mbahen ligjëratat.

Edhe pse të gjitha fakultetet kanë autorizuar të paktën një person që të kontrollojë në hyrje të objekteve nëse po respektohen masat kundër koronavirusit, ata për një kohë të gjatë nuk janë parë në hyrje të fakulteteve.

Mungesë e këtij kontrolli vërehet edhe në fakultetet e tjera, si të Arteve dhe të Edukatës Fizike.

Prorektori për Zhvillim dhe Cilësi, Elton Bahtiri, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se strukturat e fakulteteve kanë vendosur persona përgjegjës për t'i kontrolluar të gjithë studentët që hyjnë në fakultete nëse janë të vaksinuar kundër koronavirusit.

Megjithatë, ai nuk është i sigurt nëse kontrollohen të gjithë studentët. "Ky personi përgjegjës

duhet të kërkojë nga gjithsecili person që futet në fakultet dëshminë e vaksinimit apo testet e caktuara. Në të kundërtën, ata që nuk janë të vaksinuar duhet të kthehen prapa", thotë Bahtiri.

Në Rektoratin e UP-së thonë se mbi 84 000 studentë janë të vaksinuar me dozën e parë, ndërsa 58 536 janë të vaksinuar me të dyja dozat e vaksinës.

Prodekani i Fakulteti Juridik, Florent Muçaj, në një përgjigje me shkrim për Radion Evropa e

Lirë, thotë se në kuadër të këtij fakulteti personeli i sigurimit është angazhuar që të bëjë kontrollet për vaksinim ashtu siç kërkohet edhe me vendimin e qeverisë. Sipas tij, këto kontrolle bëhen në mënyrë të rregullt.

Mirëpo, kur gazetarët e "Radios Evropa e Lirë" ishin të pranishëm në hyrje të këtyre dy fakulteteve, studentët nuk kontrolloheshin në hyrje dhe as personat përgjegjës për këto kontrolle nuk gjendeshin në hyrje të objekteve.

Brenda Fakultetit Juridik, në sallat ku mbahen ligjëratat, janë të vendosura shenjat që ua bëjnë me dije studentëve ku duhet të ulen në mënyrë që ta mbajnë distancën fizike, të kërkuar sipas masave të qeverisë.

Nexhmie Vokshi, profesoreshë në Fakultetin Ekonomik, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se vetëm studentët e vaksinuar dhe ata që ofrojnë dëshmi se nuk janë të infektuar me koronavirus, mund t'i ndjekin ligjëratat.

Kurti: Digjitalizimi, një nga objektivat kryesore të programit tonë

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë në konferencën më të madhe në rajon në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK), në ambientet e Parkut të Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren.

Ai në fjalën e tij në hapje të "KosICT 10" ka vënë theksin te rëndësia e transformimit digjital, si një shtytës i rëndësishëm, sipas tij, i produktivitetit dhe rritjes në ekonomi. "Digjitalizimi është një nga objektivat kryesore në programin tonë qeverisës. Agjenda e re digjitale do të jetë një nga pikat kryesore të strategjisë sonë të re kombëtare të zhvillimit. Ne synojmë ta

përdorim transformimin digjital si një nxitës për ta përmirësuar administratën tonë publike, sistemin tonë arsimor, sektorin e shëndetësisë, sistemin e drejtësisë dhe të gjitha fushat e tjera të qeverisjes, ka njoftuar zyra e kryeministrit. Sipas kësaj zyre, Kurti ka thënë se do të angazhohet për ta bërë Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren një qendër kombëtare dhe rajonale për ndërmarrësi dhe inovacion. Si pjesë e pakos së ringjalljes ekonomike është një masë e cila mbështet trajnimet për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe subvencionon pagat për të rinjtë që do të punësohen në këtë sektor.



Fushata zgjedhore për balotazh, vetëm pesë ditë



EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 TETOR - Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, ka bërë me dije se KQZ-ja ka miratuar planin operacional për organizimin e raundit të dytë të zgjedhjeve. Ai ka thënë se fushata zgjedhore për balotazhin do të jetë pjesë ditë, nga 8 nëntori deri më 12 nëntor. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar planin operacional

për organizimin e raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave. Fushata zgjedhore për subjektet politike dhe kandidatët për kryetarë do të jetë pesë ditë. Do të fillojë nga 8 nëntori dhe do të përfundojë më 12 nëntor", ka thënë ai.

Ai ka treguar se për votuesit nga jashtë që janë regjistruar nga 10 korriku deri më 18 gusht KQZ-ja ka vendosur 15 ditë në dispozicion që t'i dërgojnë fletëvotimet e tyre përmes postës.

Elezi ka thënë se kjo do të fillojë nga 29 tetori, ndërkaq fletëvotimet duhet të pranohen nga KQZ-ja më së largu deri më 12 nëntor.

Rezultatet preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kanë treguar se në raundin e parë vetëm partitë opozitare kanë fituar komuna. Sipas këtyre rezultateve, më 17 tetor janë zgjedhur kryetarët e 17 komunave, ndërkaq në balotazh do të shkojnë 21 komuna.

Myftiu Tërnavë në mesin e 500 personaliteteve më me ndikim në botën islame

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Edhe në edicionin e sivjetmë të përzgjedhjes së personaliteteve myslimane më me ndikim, Qendra Mbretërore për Studime Islame dhe Strategjike (The Royal Islamic Strategic Studies Centre) me seli në Jordani, myftiun e Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavë, e rizgjedh njërin nga 500 myslimanët më me ndikim në botën islame. "Në përshkrimin e bërë me rastin e përzgjedhjes, spikas meritat e myftiut Tërnavë për organizimin

administrativ të jetës fetare në një vend të dalë nga lufta, dëmet e së cilës ishin të mëdha e të shumta si në njerëz, po ashtu edhe në infrastrukturë. Roli i tij çmohet edhe për kultivimin e tolerancës dhe mirëkuptimit ndërfaqet në Kosovë", thuhet në njoftimin e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Në këtë njoftim theksohet se: "Ky vlerësim jubilar për myftiun e Republikës së Kosovës është një nder jo vetëm për myftiun Tërnavë dhe BIK-un, organizatën

fetare më të madhe në vend, por edhe për Kosovën. Vlerësimet e këtyra, që janë rezultat i punës dhe angazhimit serioz në ndërtimin institucional të jetës fetare, në ndërtimin e urave ndërmjet komuniteteve tradicionale fetare në vendin tonë dhe në angazhimin për mirëqenien e popullit në përgjithësi, duhet të paraqiten para botës mbarë si dëshmi të pjekurisë institucionale e qytetëruese të Kosovës dhe institucioneve të saj".



Më 29 nëntor fillon intervistimi i 21 kandidatëve për drejtor të AKK-së



PRISHTINË, 22 TETOR - Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen Agjencisë kundër Korrupsionit ka njoftuar se më 29 nëntor do të fillojë intervistimi i 21 kandidatëve për pozitën e drejtorit të kësaj agjencie.

Deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj, ka treguar në detaje për punën dhe raportin lidhur me aplikacionet e pranuar për pozitën e drejtorit të kësaj

agjencie. "Ne m datën 21 kemi shqyrtuar aplikacionet për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Nga 25 aplikacione, katër prej tyre nuk i kanë plotësuar kriteret për të vazhduar tutje, ndërsa të tjerët do të vazhdojnë tutje. Kemi punuar për rreth shtatë orësh për t'i shikuar në detaje këto aplikacione", ka thënë Selmanaj. Të pranishëm në këtë komision në mënyrë online ishin edhe

përfaqësues nga ambasada britanike që janë duke monitoruar këtë proces.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen Agjencisë Kundër Korrupsionit, Adnan Rustemi, ka thënë se data e mbajtjes së intervistimit do të jetë më 29 nëntor, ndërsa faza për trajnimin e anëtarëve të komisionit do të vendoset në ditët në vazhdim.

FSK-së iu shtuan edhe 180 ushtarë të rinj

EPOKA
ERE


Qendresa RAMA

FERIZAJ, 22 TETOR - Të premtën në Kazermin e FSK-së "Skënderbeu" në Ferizaj është mbajtur ceremonia e betimit të 180 rekrutëve të rinj. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, si dhe zyrtarë të tjerë të lartë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Certifikimi i 180 ushtarëve të rinj është bërë në kuadër të ngritjes dhe zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme operacionale bazuar në planin gjithëpërfshirës të tranzicionit të

FSK-së. Me këtë rast, presidentja Osmani u shpreh se si komandante supreme e FSK-së është krenare që po e sheh çdo ditë përparimin e FSK-së. "Këta 180 rekrutë janë ushtarë të Republikës së Kosovës, shtetit të pavarur, sovran e me territor të pacenueshëm. E ardhmja garantohet duke ndërtuar këta, prandaj sot po zgjerohet baza e forcave tona të armatosura. Forca jonë është në funksion të mbrojtjes së sovranitetit dhe paprekshmërisë së territorit", ka thënë Osmani gjatë kësaj ceremonie.

Gjithashtu, ajo u shpreh e kënaqur me praninë e vajzave dhe grave në mesin e rekrutëve të



rekrutëve shoh 12 gra. Hapja e FSK-së ndaj vajzave dhe grave nuk është nevojë, por edhe domosdoshmëri", theksoi më tej ajo. Në fjalën e tij të rastit, kryeministri Albin Kurti iu drejtua rekrutëve të rinj duke u thënë se: "Duke qenë pjesë e FSK-së, përveç privilegjit, tash e tutje do t'i shërbeni institucionit më të besueshëm në vend. Ju keni nderin t'i shërbeni vendit tuaj përkrah aleatëve, ushtarëve të NATO-s, në shërbim të paqes dhe

sigurisë globale", ka thënë ai. Më tej, kryeministri Kurti ka theksuar se qeveria e udhëhequr nga ai është e përkushtuar për rritjen e sigurisë dhe mbrojtjen e sovranitetit dhe territorin e Republikës së Kosovës.

Ndërsa në fjalën e saj, komandantja e KDS-së, gjeneralbrigade Irfete Spahiu, theksoi se kjo gjeneratë e rekrutëve është një nga gjeneratat me rezultatet më të mira që ka pasur KDS dhe se ka vendosur një standard të ri të performancës.

Nis vaksinimi i qytetarëve nga ekipet mobile në Prishtinë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 TETOR - Në Prishtinë ekipet mobile kanë nisur të premtën vaksinimin e qytetarëve kundër Covid-19. Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se ekipet mobile do të jenë në sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë me fillim nga ora 10:00 deri në orën 17:00 për t'u mundësuar qytetarëve që të vaksinohen. Kjo ministri u ka bërë thirrje qytetarëve që ta shfrytëzojnë edhe këtë mundësi shtesë për t'u imunizuar kundër koronavirusit si rruga më e sigurt për parandalimin e infektimit nga Covid-19.

Menaxheri i qendrës së vaksinimit në Prishtinë, Niman Bardhi, ka thënë se kjo formë e vaksinimit po bëhet në mënyrë "që të jemi sa më afër qytetarit". "Në kuadër të planit të paraparë, kemi parë që do të bëhet edhe vaksinimi përmes ekipeve mobile. Sot për herë të parë është ngritur tenda me ekipin mobil të vaksinimit në sheshin 'Zahir Pajaziti', por një gjë e tillë do të fillojë së zbatuari në nivel vendi", ka thënë Bardhi.

Ai ka sqaruar se në tentat e ekipeve mobile do të bëhet vaksinimi vetëm me dozën e parë, kurse dozën e dytë qytetarët duhet ta marrin në qendrat e vaksinimit.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 5 287 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 525 230 doza të vaksinës. Deri më sot 691 004 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Nga 2 115 testime, 16 qytetarë kanë rezultuar pozitivë të premtën me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të premtën janë shëruar 45 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 151. Në total numri i rasteve aktive me Covid-19 është 481.

Nikolla: Këshilli i Evropës do të jetë i paplotë derisa ta pranojë Kosovën

Athinë, 22 tetor - Kryeparlamentarja e Shqipërisë, Lindita Nikolla, mori të premtën fjalën në konferencën e kryetarëve të parlamenteve të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës në Athinë, ndërsa vuri theksin në kontinentin evropian, si kontinenti i

asimetrive, më konkretisht në dallimin midis vlerave që qëndrojnë në themel të Këshillit të Evropës dhe qëndrimeve të disa vendeve anëtare të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor. Ajo ka thënë se vlerat evropiane janë të pagarantuara, me Ballkanin Perëndimor jashtë BE-së dhe

Kosovën jashtë Këshillit të Evropës. "Këshilli i Evropës do të mbetet i paplotë derisa ta pranojë Kosovën, shtetin më të ri të Evropës, një shtet i ri i krijuar nga Evropa atlantike, bashkë me aleatët strategjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës", u shpreh ajo.



Eksporti dhe importi gjatë shtatorit, ASK-ja publikon të dhënat

PRISHTINË, 22 TETOR (ER) - Të dhënat nga Tregtia e Jashtme e Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar më të lartë për 43.1 për qind në muajin shtator 2021 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2020, gjegjësisht në vlerë prej 351.3 milionë eurosh, krahasuar me deficitin 245.5 milionë eurosh në vitin 2020. Në njoftimin e ASK-së thuhet se eksporti mbulon importin me 16.5 për qind.

Eksporti i mallrave në muajin shtator 2021 kishte vlerën 69.3 milionë euro, ndërsa importi 420.6 milionë euro, që është një rritje prej 66.2-përqindësh për eksport dhe 46.4 për qind për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020.

Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 29.4 për qind të eksporteve e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 24.4 për qind e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 9.8 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 7.9 për qind e

përbëjnë produktet bimore; 7.2 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 5.9 për qind e përbëjnë produktet minerale; 3.3 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, etj.

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 16.3 për qind e përbëjnë mjetet e transportit; 13.1 për qind e përbëjnë produktet minerale; 12.4 për qind e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 10.5 për qind e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10.2 për qind e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 6.8 për qind e përbëjnë produktet e industrisë kimike; 6.8 për qind e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre, etj.

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së (27) arritën në 19.3 milionë euro, ose rreth 28 për qind e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 40.4-përqindësh. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (8.6



për qind), Italia (5.8 për qind), Holanda (2.4 për qind), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së (27) ishin rreth 158.0 milionë euro, ose 37.6 për qind e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 34.7-përqindësh. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (11.4 për qind), Greqia

(4.2 për qind), Sllovenia (4.0 për qind), Italia (3.9 për qind) etj.

Në muajin shtator 2021 eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-së arritën në 23.4 milionë euro, ose 33.8 për qind të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 26.1-përqindësh. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-së

ishin: Shqipëria (14.2 për qind), Maqedonia e Veriut (10.8 për qind), Serbia (4.8 për qind), dhe Mali i Zi (3.0 për qind).

Ndërsa importet nga vendet e CEFTA-s në muajin shtator 2021 arritën në 78.8 milionë euro, ose 18.7 për qind të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 26.1-përqindësh. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Shqipëria (6.2 për qind), Serbia (6.0 për qind) dhe Maqedonia e Veriut (5.0 për qind).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 26.5 milionë euro, ose 38.2 për qind. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport vlen të përmenden: ShBA-ja (19.2 për qind) dhe Zvicra (6.6 për qind).

Ndërsa importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 183.8 milionë euro, ose 43.7 për qind. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin Turqia (11 për qind) dhe ShBA-ja (10.9 për qind).

Nënshkruhet marrëveshja për tregjet e energjisë elektrike Shqipëri - Kosovë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

TIRANË, 22 TETOR - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), Enti Rregullator i Energjisë së Shqipërisë (ERE) dhe operatorët e sistemeve të transmetimit të Shqipërisë dhe Kosovës (OST dhe KOSTT), të mbështetur nga USAID-i, kanë nënshkruar në Tiranë marrëveshjen kornizë të bashkëpunimit të tregjeve të energjisë elektrike.

Kjo marrëveshje përcakton të drejtat, detyrimet dhe hapat e nevojshëm që palët nënshkruese duhet të ndërmarrin për të bashkëpunuar në lidhje me organizimin e tregjeve të bashkuara të energjisë elektrike të një ditë më herët dhe brenda ditës për sa iu përket roleve dhe përgjegjësi në lidhje me operimet, administrimin dhe vendimmarrjen, përmes organizimit të alokimit të kapaciteteve ndërkufitare të transmetimit në kufijtë e tyre të përbashkët një ditë më herët dhe brenda ditës.

Bashkimi i tregjeve të energjisë elektrike do të kontribuojë në zgjerimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe rritjen e konkurrencës në tregjet e energjisë elektrike si dhe në ruajtjen dhe zgjerimin e një tregu me çmime të drejta.

Ky bashkëpunim do të përforcojë shfrytëzimin më efikas të interkoneksioneve të përbashkëta ndërkufitare përmes metodave objektive të bazuara në treg jodiskriminuese dhe transparente.



Po përmes këtij bashkëpunimi do të ofrohet hyrja korrekte dhe jodiskriminuese në tregun e

ditës në avancë dhe brenda ditës duke nxitur efikasitet të përfitimeve në të dy tregjet e

energjisë elektrike. Ky bashkëpunim, si i pari në rajon në një treg të përbashkët, do të

shërbejë si nxitje për zgjerimin e bashkimit të më shumë tregjeve në rajon e më gjerë.

Arkipelagu Jugosllavia 1991-2021



NGA: XHEVDET BAJRAJ

Notat e para muzikore të Funeral blues-it për Jugosllavinë u dëgjuan një vit pas vdekjes së Titos; melodia zgjati rrafsh dhjetë vjet dhe pastaj filloi vallja e përgjakshme e shpërbërjes së Jugosllavisë e cila, fatkeqësisht, zgjati pothuaj dhjetë vjet. Jugosllavia e kishte një sistem politik socialist me fytyrë njeriu, së paku ashtu u pëlqente ideologëve të asaj kohe ta cilësojnë; ishte e bukur apo e shëmtuar ajo fytyrë, nuk ka rëndësi, por bota nuk e njeh një shtet (ish) socialist ku jetohej më mirë.

Ajo që akoma nuk mund ta kuptoj është se si popujt e sllavëve të jugut ia lejuan vetes luksin ta shkatërrojnë atë shtet, sidomos kur t'i kemi parasysh ofertat që ua bënte bota perëndimore që Jugosllavia të bëhej pjesë e saj. Ishte hera e dytë që Jugosllavia socialiste e përdori një jo të madhe karshi ofertave që i vinin nga jashtë, hera e parë BRSS-së, hera e dytë botës perëndimore. Njerëzit do të duhej ta dinin se gjeografia vret; i vret njerëzit që banojnë aty. Lufta për pushtet di të jetë edhe më e keqe se vet pushteti. E vetëm pushteti, në vendet e sapodala nga lufta, mes rrënojave, ua mundëson liderëve një kolltuk, një fron, që ua siguron të pushojnë nga krimet që i kanë bërë në luftë dhe krimeve që do t'i

bëjnë në paqe.

I dëgjoja lajmet nga lufta në Slloveni, Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë; përipiqesha ta paramendoja ferrin, atë çnjerëzoren që me hapa të sigurt po vinte drejt Kosovës. Natyrisht, erdhi, dhe çdo gjë shkoi përtej imagjinatës sime. Dikush sezonin e hapur të gjuetisë ndaj një kombi të tërë e quante luftë.

Kështu vërtetohet se ruga më e shkurtë e evoluimit të njeriut nga Ballkani është ajo nga majmuni në politikan, në raste të posaçme në lider të kombit, të shumtën, në historian akademik. Kështu që, të gjithë popujt ballkanikë janë krenarë me historinë e tyre. Si të mos jenë? Ata vetë duan ta interpretojnë realitetin; e kanë programin Word të instaluar në kompjuter, paçka që nuk kanë tru. Kështu ndodh që brenda një shteti mësohen histori që bien ndesh me njëra-tjetrën, varësisht cilit komb i takojnë nxënësit. Historia ta lë përshtypjen se është një depo që shërben për grumbullimin e gënjeshtreve. Pastaj vjen një i ri nga Anglia, që quhet ta zëmë Noel Malcolm, dhe e shkruan nga një histori të shkurtër për kombet e që nuk mund ta mohojë asnjë historian vendas. Mund të jetë edhe bren shpirtin e njeriut. Disi e bën vdekjen më të njerëzishme. E, kujtesa është zanati i poetëve, e

vetmen gjë që di; e jep kontributin e tij në zvogëlimin e dallimit midis njeriut dhe gomarit. Ajo, injoranca, e ka shëndetin e mirë në teatrin e përgjakur ballkanik dhe parashihet që do ta ketë një jetë të gjatë.

Lufta. Kam parë beteja dhe epope, më ka parë gryka e revoles dhe e kallashnikovit; më ka goditur çizmja paramilitare. Kam qenë në zonë të lirë dhe të pushtuar, kam qenë i arrestuar; kur më dëbuan ma morën edhe letërnjoftimin ... Kam parë trima që janë shndërruar në fëmijë qurravec dhe fëmijë që janë shndërruar në trima. Jam ngopur me luftë, me rrënoja mbi tokë dhe me qiell përplot sorra. Jam ngopur duke u përshëndetur me gruan dhe me dy fëmijët e mi disa herë përgjithmonë. Jam ngopur e stërngopur, sepse luftën e kam marr me vete edhe këtu në Meksikë dhe që njëzet e një vjet përditë ballafaqohem me të. Prandaj, s'do ta them më asnjë fjalë për të.

Lumi i kujtesës, të mbijetuarit e luftës i dërgon buzë humnerës. Humnerën e ndjejnë, e shohin, e prekin, nganjëherë, ecin mbi të, disa prej tyre arrijnë të dalin në bregun tjetër, por vazhdojnë të janë të thyer. Krimbi i kujtesës e bren shpirtin e njeriut. Disi e bën vdekjen më të njerëzishme. E, kujtesa është zanati i poetëve, e

poeti nuk e ka luksin ta heq shikimin nga kjo pamje. E keqja është se ai nuk e ka as luksin të hidhet në këtë humnerë, se tashmë ai veç gjendet në fund të saj. Kjo vazhdon të përsëritet me shekuj, sepse historia e ka aftësinë për t'u ricikuar në çdo gjeneratë. Poetëve u mpihen dhëmbët nga frutat e kujtimeve të luftës që kurrë nuk arritën të piqen brenda shpirtit të tyre, e nuk kanë ç'të bëjnë më shumë përveçse të bredhin fushave të tyre të mallit, fushave të dhunuara të lirisë. Jeta mund të jetë më e frikshme nga sa ne jemi të gatshëm të pranojmë; është një poezi e pakufishme e trishtimit.

Në Meksikë erdha falë bursës së Parlamentit Ndërkombëtar të Shkrimtarëve që e kishte selinë në Paris. E kisha me vete një çantë krahu dhe një qese najloni; gruaja e kishte çantën e vet po ashtu të krahut, ndërsa fëmijët i kishin duart e lira. Klima, ushqimi, ngjyrat e shtëpive, bimët tropikale, shtëpia ku isha i vendosur dhe, ajo që është më me rëndësi, paqja në të cilën e kisha aq vështirë të përshtatesha e të kuptoja që askush nuk më ndiqte, që nuk do të vinte ta shqelmonte derën e të më vriste, të gjitha këto bënë që shpesh të zgjohesha pas mesnatës, ta shikoja gruan, të shikoja në dhomën e fëmijëve e t'i shikoja mirë e mirë një copë herë,

dhe pastaj të mendoja mos na kishin vrarë që të gjithëve dhe tash gjendemi në Parajsë. Vetëm fakti që unë nuk e flisja gjuhën spanjolle dhe, në rrugët e pjesës së qytetit të Meksiko Sitit ku jetoja, njerëzit flisnin vetëm në gjuhën spanjolle, ma përkujtonin se isha gjallë, sepse kurrë nuk kisha dëgjuar se në Parajsë flitet vetëm spanjisht. Shpejt e gjeta cigaren time të preferuar, tekilën e birrën po ashtu. Por, së paku dy muaj nuk e kam shkruar as një varg të vetëm. Dikur ia fillova dhe nuk u ndala një kohë të gjatë. Ashtu lindi El tamaño del dolor (The size of the pain) që në shqip mbase edhe nuk ka përkthim adekuat, diçka si Përmasa apo Madhësia e dhimbjes.

Që njëzet e një vjet më vret Meksika me bukuri; që njëzet e një vjet më vret malli për Kosovë, që po aq vite çdo verë më vret realiteti kosovar. Nejse, shkoj atje si fëmijë dhe kthehem si plak. Sllavët e jugut jetës i thonë: Život, kjo na çon te životinja (kafshë/shtazë), nga kjo rrjedh folja životariti (të jetuarit keq), gegjësisht životinjariti (të jetuarit edhe më keq, si kafshë).

Si me magji fjala Život (jeta) lëviz sa para aq edhe prapa. Pra, disi shkurohet distanca mes jetës (Život) dhe të jetuarit në mënyrë kafshërore (Životinjariti). Diku atje lartë mbi ne është Zoti, apo

gëthkash përreth nesh është zoti i Spinozës apo i Nikos Kazantzakis-it. Ta shikosh Zotin në sy, i thyer, ta kuptosh se edhe Ai (apo ai) është mëkatar, e zë gjumi nganjëherë, apo është i sëmurë, do të thotë ta jetosh ditën e papërshtatshme e të të qenit njeri. Të vazhdoj edhe pak me përkthim, po e thirri në kujtesë proverbin e njohur latin: "Unë jam njeri, asgjë njerëzore nuk është e huaj për mua" (Terenci), apo i thyeri para Zotit. Kjo thënie, sipas zotit të Spinozës, do të mund të interpretohej si: "Unë jam shtazë/kafshë, asgjë shtazarake/kafshërore nuk është e huaj për mua". Është një kritikë e ashpër ndaj asaj që pushon së qeni njerëzore.

Në kujtesën e gjeneratës sime, të gjeneratave të mëparshme gjithashtu, emri Marigonë na përkujton vajzën që e mbante këtë emër dhe mbahet mend për qëndisjen e flamurit të ngritur nga Ismail Qemali gjatë Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë më 28 nëntor 1912. Pas mbarimit të luftës në Kosovë, elita e re e politikanëve dhe e "intelektualëve" u përkujdes që ta pasurojnë kuptimin e këtij emri, kështu që emëruan lagjen e tyre me këtë emër. Kur kriminelët bëjnë humor, i bëjnë njerëzit të qeshin nga dhembja, apo njerëzit me vullnetin e tyre, grimasën e dhembjes në fytyrë e përcjellin me një zë të fortë të të qeshurës, qeshin me lot, qeshin e qajnë, si të marrë, si të mjerë.

Njerëzit çdo ditë e braktisin Kosovën, njëjtë si Serbinë, Bosnjë e Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi. Tash ke lagje të tëra me shtëpi të reja, por pa njerëz; fshatra me shumë pak banorë, tokat e punës qeshin e qajnë edhe ato, rënkojnë. Edhe lufta për liri, si revolucionet, i hanë bijtë e vet, por janë ca të pafytyrë që i kanë shpëtuar vdekjes e kthehen dhe ashtu si i kanë ngrënë frytet e revolucionit, tash i hanë frytet e luftës për liri. Këta zakonisht vijnë nga pala e mposhtur në momente vendimtare të historisë, qofshin ballistë, çetnikë, ustashë, e tash këtë mund ta themi edhe për komunistë apo të tjerë; në të tjerë mund ta fusim kthimin e rrufeshëm të ndikimit të religionit/fesë në shtetet e reja, zyrtarisht laike, ku mbinë si kërpudhat pas shiut kisha e xhami politike. Sa më afër këtyre xhamive e kishave që të jenë, duket se njerëzit janë më larg nga Zoti.

Njerëzit do të ishin shumë më të lumtur, më të shëndetshëm mentalisht, në një sistem vlerash normale, në të cilën arsimit, shëndetësia dhe kultura do të ishin në nivel më të lartë. Koha që e kemi lënë pas dëshmon se në natyrën e shpezëve dhe të kafshëve që ua ka ëndja të ushqehen me kufoma të njerëzve, është t'i vizitojnë fushëbetet. Historia na dëshmon se, për fat të keq, fundi i luftës shpesh e nënkupton fillimin e korrupsionit. Ka njerëz që shkatërrojnë mite dhe mbi rrënojat e miteve të vjetra ndërtojnë mite të reja vetëm për ta glorifikuar veten, epokën e tyre. Njerëzit që e braktisin vendin,


përsëriten me statujat e të rënëve për liri e nga të cilat politikanët kanë vjedhur nëpër tenderat e hapur për ndërtimin e tyre. Ndërsa planeti ballafaqohet me ndryshime klimatike, bastardët e luajnë rolin e heronjve të gjallë dhe gjuajnë me armë në tavane, e shfrytëzojnë rastin derisa t'u ftohet mezja mbi tavolinë. Janë pjesë e peizazhit që me shpejtësi marramendëse shkon rrugës njëkahëshe drejt ndeshjes me apokalipsin që po vjen po asaj rruge.

Politika e mëparshme serbe e pati krijuar një çelës për dyert që nuk ekzistojnë dhe rajoni nuk mund të lëvizte përpara, problemi është që i mbajti peng disa popuj dhe së bashku me ta i mëshoi murit me kokë dhe u përgjakëm që të gjithë. Presidenti i tanishëm në të njëjtin mur e ka vizatuar një derë dhe përpigjet të kaloj nëpër të. E keqja është se përveç popullit të tij me vete përpigjet t'i marrë edhe dy-tre kombe të tjera që vazhdon t'i mbajë peng. Edhe po të mund të kalonte nëpër atë derë/mur, qëllimi nuk është që të shkohet përpara, drejt një të ardhme më të mirë, por për t'u kthyer që të gjithë në një të kaluar. Koha është shumë e rëndësishme, është vetë jeta dhe sido që të jetë ajo, rrjedh, ikën pamëshirshëm/ pakthyeshëm. Mbase dikur do të bëhet më mirë, por shumica nga ne dikur nuk do të jemi këtu. Po të isha i verbër, do të jetoja në errësirën time, e kështu si qëndron puna, pat thënë dikush, jam i dënur të jetoj në errësirën e të tjerëve. Në errësirën që na imponojnë të fortit të cilët insistojnë që liria lyhet në një rrishtë buke të imagjinuar dhe hahet.

Një numër i shteteve që lindën nga shkatërrimi i ish Jugosllavisë ende nuk janë liruar nga nacionalizmi primitiv. Jetojmë në një kohë të degraduar/denegjuar, në kohën e budallenjve, e idiotëve të rëndësishëm, shumë të rëndësishëm.

Thoshte Nikos Kazantzakis: "Çfarë makine e çuditshme është njeriu! Ju futni në të bukë, verë, peshk dhe rrepë dhe dalin psherëtima, të qeshura dhe ëndrra", por ai njeri nganjëherë e merr një kallashnikov dhe shtie në njerëzit e tjerë apo një thikë dhe me të ia pren kokën një njeriu tjetër. E kjo shpesh jetën e shndërron në një filxhan kafeje tashmë të ftohur që njeriu e pi fillikant vetëm, apo në rastin më të mirë, në botën virtuale, por kjo nuk ua ndalon që të vazhdojnë të ëndërrojnë hakmarjen. Errësira që ka kohë që mbretëron në atë pjesë të vogël të botës, shumicën e njerëzve i bënë të njëjtë, të pagojë, heshtin për të jetuar në paqe dhe turpshëm, për 3-4 qind euro në muaj. E vetmja gjë që do ta bëjë diferencën, apo që është me rëndësi jetike, është se çfarë ishin para se të futen në atë errësirë.

Pasi e urrejtëm njëri-tjetrin, pasi vazhdojmë të urrehemi mes vete, erdhën njerëz nga të katër anët e botës për të na trajnuar si të ishim kafshë të egra, për të na mësuar se si të bashkëjetojmë, neve, që kishim bashkëjetuar aq vjet me



NGA: XHEVDET BAJRAJ

njëri-tjetrin, apo pranë njëri-tjetrit. Në luftën e Kosovës, mbi 1300 qytetarë, fëmijë, gra e pleq u "vetëvranë", praktikisht disa herë e varrosën veten. Si duket nuk u pëlqente vendi, kështu që disa herë i ndërruan varret e tyre, e pastaj udhëtuan në mënyra të ndryshme për në Serbi dhe atje fshihen aq mirë sa që nuk ka njeri që i gjen më. Disa prej tyre nuk e kishin këtë fat; u gjetën në Batajnicë dhe në liqenin Peruqac. Këtë e kanë bërë vetëm për ta njollësuar liderin e sotëm ballkanik i cili vendin e parë të punës e kishte t'i shkante pas me arkë birre një horri që kërcënonte popuj të tërë që do t'i vriste me lugë të ndryshkur, vendi i dytë i punës, zëdhënës i Millosheviqit, vendi i tretë i punës kryeministër, e vendi i katërt i punës kryetar i shtetit. Natyrisht, gjithmonë i shoqëruar nga moshatari i tij, një shok i luftës, që i shërben për t'i argëtuar me këngë kryeministrat apo kryetarët e shteteve të rrallë që i shkojnë për vizitë, e që njihet me pseudonimin Valixhja nga Zhitoragja. Valixhja sepse një herë e patën zënë me një valixhe përplot para nga bakshishet. Ndërmjet këngëve, gjatë pauzës, nga ekrani televizorit i kërcënonte qytetarët e Serbisë në rast se i tregojnë botës ku janë të varrosur shqiptarët në Serbi, apo nëse i zbulojnë kriminelët. Pra, zoti Valixhja është një primitiv i përsosur. Është ai që po i vret edhe një herë pas njëzet e dy, gjegjësisht edhe pas njëzet e një viti, sa për t'u siguruar që me të vërtetë janë të vdekur.

Në luftën, jo për mbijetesë, por për zgjerimin e territoreve, disa me zell të jashtëzakonshëm kanë kontribuar në krijimin e klimës së

përshtatshme për të vranë gra, pleq e fëmijë. Për të dhunuar, për të torturuar, për të plaçkatur: para, ari, vetura, televizora, frigorifera, lavatriqe. Kjo është jeta, një libër i gjallë i mbushur me vdekje që kurrë nuk del nga qendra e vëmendjes; rrathët koncentrik që i shkakton kur bie në ndërgjegjen e njerëzve, nuk arrijnë t'i zgjojnë nga gjumi i thellë i injorancës. Ashtu janë të stërvitur, për të mos dëgjuar, për të mos parë, për të mos ndjerë. Sido që të jetë, kjo ata nuk i liron nga përgjegjësia, e aq më pak ata që me vetëdije të plotë i kanë krijuar ato rrethana politike. Të tjerët? Të tjerët janë të detyruar që rrugën që do t'i shpie në ditën e nesërme, ta zgjedhin nën presionin e frikës. Të kërkojnë derë që do t'i nxjerrë nga ai realitet, pjesë e të cilit janë.


Në Kosovë, në të vetmin shtet evropian në të cilin aplikohen vizat, të rinjtë ëndërrojnë të ikën sepse u duket e pamundur ta ndërrojnë atë realitet. Iu deshën njëzet e një vjet politikanëve për ta rrënuar arsimin, shëndetësinë, kulturën/artin, për të ndërtuar përmendore të reja, për t'iu ndërruar rrugëve emrat. Për t'i privatizuar fabrikat, tokën shoqërore në të cilin çmimi për një ari tokë sillej nga 1 euro deri në 3 euro e 75 cent, natyrisht, jo për të gjithë, por për politikanët e fortë. Ti mund ta lozësh rolin e berberit dhe t'ia ruash një të vdekuri mjekrën, apo t'i bësh makijazh. Kjo e zburon atë, por nuk e ngjallë. Njëzet e një vjet iu është dashur politikanëve për të mos bërë asgjë. Historia ka dëshmuar se në të shumtën e rasteve, pas diktatorëve të famshëm, në pushtet vijnë bastardët, bijtë bastardë të vendit të vet, sepse dhuna në mënyrë të

pashmangshme tërheq njerëz me cilësi të ulëta morale, njerëz që shkatërrojnë mite dhe mbi rrënojat e miteve të vjetra ndërtojnë mite të reja vetëm për ta glorifikuar veten. Shkrimtari Ernesto Sabato shkroi se në jetojmë në një kohë kur e ardhmja duket e shkatërruar, kjo kohë është e sëmurë, është diagnozë, duhet të turpërohemi për botën që po ua lëmë gjeneratave të reja dhe natyrisht, t'u kërkojmë falje atyre që mundemi, fëmijëve tanë që i kemi sjellë në këtë botë.

Neve gjërat na ndodhin; ne në të shumtën e rasteve nuk vendosim për këtë. E presim ditën e nesërme, ndërsa në Meksikë e kam mësuar që e nesërmja kurrë nuk vjen. Ajo quhet ashtu mu për arsyen se nuk vjen kurrë. E nesërmja është vet vdekja. Meksika po ashtu ma ka imponuar t'ia rifilloj jetës. Ekzistojnë humbje që kurrë nuk rindërtohen, nuk mund të korrigjohen.

PS. Ky shkrim i poetit të njohur shqiptar, Xhevdet Bajraj, fillimisht është publikuar në gjermanisht nga Traduki. Këto ditë doli në portalin Nomad të Bosnje dhe Hercegovinës – portal ky që promovon idenë për shoqërinë ku të gjithë qytetarët kanë të drejtë të patjetërsueshme për liri të mendimit, të veprimt, të të shprehurit, leximit, shkrimit e lëvizjes. Në gjuhën boshnjake është përkthyer nga Merima Krijezi. Bajraj prej vitit 1999 jeton në Meksikë. Është profesor i Letërsisë dhe i Shkrimit Kreativ në Universitetin Autonom të Meksiko Sittit. Me leje të autorit, Telegrafi e solli këtë shkrim në shqip.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Dardanet U19 fitojnë edhe në ndeshjen e dytë në kualifikimet për Euro 2022

PRISHTINË, 22 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës U19 në konkurrencën e femrave ka shënuar fitore ndaj Lihtenshtajnit me rezultat të ngushtë 2:1.

Përfaqësuesja e Kosovës U19 në konkurrencën e femrave ka shënuar fitoren e dytë në kualifikimet për Kampionatin Evropian 2022 që po zhvillohet në Poreç.

Në ndeshjen e dytë të Grupit 5 në Ligën B, dardanet U19 kanë shënuar fitore ndaj Lihtenshtajnit me rezultat 2:1. Të dyja golat për Kosovën i shënoi Fortesa Berisha (5' dhe 65').

Kjo është fitorja e dytë e vashave të drejtuara nga Kushttrim Munishi, pasi në ndeshjen e parë e kishin mposhtur Letoninë (3:0).

Ndeshjen e fundit në grup



Kosova e luan ndaj Kroacisë më 25 tetor, që do të jetë përcaktuese për kualifikim në Ligën A (fazën e dytë të kualifikimeve), pasi

kalimin tutje e sigurojnë vetëm fituesit e grupeve dhe vendi i dytë më i mirë nga gjashtë grupet e Ligës B.

Liga Unike starton këtë fundjavë, këto janë përballjet e xhiros së parë

PRISHTINË, 22 TETOR - Pritjes i erdhi fundi. Liga Unike është gati për edicionin e ri. Fundjava shënon një çast historik në basketbollin shqiptar, pasi jetësohet ëndrra për zhvillimin e Ligës ndërmjet klubeve më të mira nga Kosova dhe Shqipëria. Katër klube nga Kosova dhe Shqipëria do të përballen në Ligën Unike që fillon këtë fundjavë.

Ndeshja hapëse do të zhvillohet në kryeqytetin shqiptar ndërmjet Tiranës dhe Rahovecit. Tri sfidat e tjera do të zhvillohen të dielën. Do të përballen Prizreni 16-Kamza, Teuta-Peja dhe Vllaznia-Golden Eagle Ylli.



Skuadra e Yllit fitoi Superkupën Mbarëkombëtare që u organizua për herë të parë, ndërsa është kampione e Ligës Unike që u zhvillua edicionin e kaluar. Edicioni i ri pritet të jetë shumë

interesant dhe rivalizues, me tetë skuadrat që synojnë ta fitojnë titullin e kampionit, por edhe të shfaqin ndeshja të bukura për adhuruesit e basketbollit.

SHKURT

Pogba këmbëngul se është i lumtur te Manchester Unitedi

Mesfushori francez Paul Pogba ka thënë se është i lumtur te klubi anglez Manchester United. Pa kontratë në muajin qershor të vitit të ardhshëm, e ardhmja e Pogbas ka qenë subjekt i një shqyrtimi intensiv. Francezi është lidhur me klube të ndryshme si Juventus, Real Madridi dhe Paris Saint-Germain, por lojtari pritet të mbetet në Old Trafford. Është vetë mesfushori i cili ka deklaruar se ndihet i lumtur te klubi i tij aktual. "Sigurisht që kam besim. Përndryshe, nuk do të isha në ekip dhe nuk do të isha në këtë ekip". "Është një klub i madh. Nëse nuk je i sigurt për veten, nuk ke çfarë të bësh këtu", ka thënë Pogba për "Sony India". Ndryshe, Pogba e ka nisur pozitivisht sezonin në Ligën Premierë, duke thyer edhe rekorde të asistimeve, por ka rënë në formë në javët e fundit.

Hajdutët hynë në shtëpinë e Dybalas, thuhet se kanë vjedhur gjëra të çmuara

Sipas raportimeve në Itali, shtëpia e Paulo Dybalas në Torino është grabitur mbrëmjen e së martës ndërsa sulmuesi i Juventusit nuk ndodhej në shtëpi. Dybala aktualisht është jashtë fushës për shkak të një dëmtimi muskolor, kështu që ai nuk iu bashkua skuadrës së tij në Rusi ku Zonja e Vjetër u përball me Zenitin të mërkurën mbrëmja. Megjithatë, as sulmuesi argjentinas dhe as partnerja e tij Oriana Sabatini nuk ishin në shtëpi kur shtëpia e tyre u grabit në mbrëmjen mes të martës dhe të mërkurës. Sipas raportimeve të shumta në Itali, një roje sigurie që zakonisht patrullon zonën përreth shtëpisë së Dybalas dha alarmin kur pa lëvizje të dyshimita brenda pronës. Megjithatë, hajdutët arritën të largoheshin nga shtëpia me plaçkën, e cila, sipas "La Gazzetta dello Sport", mund të përbëhet nga koleksioni i orëve të shtrenjta të Dybalas. Nuk është hera e parë që hajdutët sulmojnë lojtarët e Juventusit në shtëpitë e tyre në Torino. Në janar shtëpia e Weston McKennie u grabit gjatë përplasjes së Juventusit në Coppa Italia kundër SPAL-it. Në të kaluarën, Mauro Camoranesi dhe Claudio Marchisio u përballën me përvoja të ngjashme me ish-mesfushorin qendror i cili ishte në shtëpi me familjen e tij kur hajdutët hynë.

Ibrahimoviqi pritet të jetë titullar te Milani pas pesë muajsh

Zlatan Ibrahimoviqi pritet të përfshihet sot (e shtunë) në formacionin titullar të Milanit kundër Bolognas, duke nisur ndeshjen e tij të parë pas pesë muajsh. Sipas mediumit "La Gazzetta dello Sport", trajneri Stefano Pioli ka të ngjarë të zgjedhë suedezin si sulmuesin e vetëm të Milanit në ndeshjen e tyre në udhëtim në Stadio Dall'Ara. Ibrahimoviqi e filloi ndeshjen e tij të fundit më 5 maj, në fitoren 3-0 të kuqezinjve ndaj Juventusit dhe nga ajo kohë kanë kaluar plot pesë muaj. Gjatë asaj ndeshje ai mori një dëmtim në gju që e detyroi të humbasë Euro 2020 dhe ndeshjet hapëse të sezonit me rossonerët.

40-vjeçari ka tri paraqitje në të gjitha garat deri më tani këtë sezon, por ai gjithmonë ka ardhur nga stoli si zëvendësues, duke shënuar një gol kundër Lazios në fitoren 2-0 në San Siro. Ibrahimoviqi luajti 32 minuta kundër Portos të martën, duke zëvendësuar Olivier Giroud në pjesën e dytë.

JAVA 1

E shtunë
17:00 Tirana-Rahoveci

E diel
17:00 Prizreni 16-Kamza
17:00 Teuta-Peja
19:00 Vllaznia-Golden Eagle Ylli

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Rama-Trans” SH.P.K. me pronar Bekim Thaqi Kramovik Rahovec, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 810388688, nrb: 80171781 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Rama-Trans” D.O.O. Bekim Thaqi Kramovik Rahovec, donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik Identifikues: 810388688, nrb: 80171781, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Rama-Trans” L.L.C. Bekim Thaqi Kramovik Rahovec, has come to the decision to quit its business: Unik Identifikues: 810388688, nrb: 80171781 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Kullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Gjengiz Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Mati Logoreci " Prizren.
- Bardhyl Sulaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu " Avdyl Frasheri " Prizren.
- ▶ Bernardina Alijaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III, IV dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” drejtimi Farmaci Gjakovë.
- ▶ Xhevdet Dervishaj nga Nasheci i Prizrenit, shpall të pavlefshme Diplomën e studimeve themelore universitare të lëshuar nga Kolegji “Dardania”, drejtimi: Banka, Financa dhe Kontabilitet.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal in më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

